

Broj - Nr 06-032/22-9356

Tuzi - Tuz, 21-09-2022 god.

RAPORT

NGA DISKUTIMI PUBLIK I KRYER

me rast të Draft Vendimin mbi përcaktimin e zonave akustike në teritorin e komunës së Tuzit

Me Konkludim numër 01-031/22- 8868 të datës 06.09.2022, Kryetari i Komunës së Tuzit, në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi vetëqeverisje lokale dhe Vendimit mbi pjesëmarrjen e popullatës lokale në kryerjen e punëve publike, ka përcaktuar **Draft Vendimin mbi përcaktimin e zonave akustike në teritorin e komunës së Tuzit** e cila është shpallur në faqen e internetit të komunës së Tuzit www.tuzi@tuzi.org.me, si dhe janë dorëzuar këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Tuzit dhe organeve lokal të komunës së Tuzit.

Draft Vendimin mbi përcaktimin e zonave akustike në teritorin e komunës së Tuzit, është vënë në diskutim publik në afat prej 15 ditësh, duke filluar nga 06.09.2022 përfundimisht me 21.09.2022.

Diskutimin publik në formë elektronike, të shkruar dhe me gojë e ka zhvilluar Komuna e Tuzit. Gjatë diskutimit publik, qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë u është dhënë mundësia e të shprehurit me shkrim, në formë elektronike dhe me gojë.

Me Program të përcaktuar është organizuar diskutimi publik qendror në lokalet e Kuvendit të Komunës së Tuzit me 14.09.2022, me fillim në ora 10:30. Në diskutimin publik qendror kanë marrë pjesë 05 pjesëmarrës, nga të cilët 02 i kanë plotësuar fletë-vlerësimin dhe në këtë mënyrë vlerësua diskutimin publik qendror. Diskutimin publik qendror kanë përcjellur përfaqësuesit e medieve të akredituar.

Në diskutimin publik qendror, prezent kanë qenë hartueset e akteve Ismeta Gjoka, sekretare e Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural dhe nëpunesi Robert Camaj, dhe Udheheqes sektori Robert Camaj.

Fjalën hyrëse mbi Propozimet e Vendimeve përkatëse ka dhënë Ismeta Gjoka, UD sekretare e Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural duke treguar se Draft Vendimin mbi përcaktimin e zonave akustike në teritorin e komunës së Tuzit është sjellur në bazë të nenit 6 dhe nenit 33 të Ligjit për Mbrojtjen nga Zhurma në Mjedis (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 28/11, 28/12 dhe 01/14, 15/9 dhe 2/18) si dhe Nenit 32 paragrafit 1 pikës 2 të Statutit të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 29/18, 34/19 dhe 38/20), dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për vlerat kufizimit të zhurmës në mjedis, mënyrës së përcaktimit të treguesve të zhurmës dhe zonave dhe metodave akustike. Poashtu ka shtuar se me ky vendim sjellet me qëllim të mbrojtjes së njerëzve nga zhurmat në mjedis, me këtë vendim, në teritorin e komunës së Tuzit përcaktohen zonat akustike në përputhje me shfrytëzimin ekzistues dhe të planifikuar të hapësirës. Në zonat akustike, është e ndaluar të shkaktohet zhurmë mbi vlerat e përcaktuara për zonën akustike të specifikuar. Në zonat e demarkacionit të zonave akustike, niveli i zhurmës në çdo zonë akustike nuk duhet të kalojë vlerën më të ulët të përcaktuar për zonën me të cilën ajo kufizohet. Vlerat kufitare nuk zbatohen për zhurmën e krijuar në ambiente të mbyllura. Niveli i

zhurmës gjatë përdorimit të pajisjeve zanore, për nevojat e tubimeve publike në natyrë, nuk duhet të kalojë 110 dB, ndërsa niveli maksimal i zhurmës nuk duhet të kalojë 120 dB i matur në një distancë prej 4 m nga burimi i zhurmës. Pavarësisht zonës akustike dhe vlerës kufitare përkatëse, zhurma që buron nga punimet e ndërtimit në hapësirë të hapur, për zbatimin e të cilave është lëshuar leja nga autoriteti kompetent, mund të kalojë vlerën kufi të përcaktuar me 5dB gjatë kohës në të cilën ndërtimi, punimet mund të kryhen në përputhje me ligjin.

Gjatë debatit publik nuk ka pasë vërejtje as sygjerime.

Debati publik përfundoj në orën 11:00.

Gjatë gjithë periudhës së paraparë për diskutimin publik, në adresën e Komunës së Tuzit, përmes arkivit si dhe përmes email-it nuk ka arritur asnjë propozim i shkruar, vërejtje apo sygjerim në lidhje me Propozimet e Vendimeve të lartpërmendura.

Raportin e perpiloi: Robert Camaj



SEKRETARE

Ismeta Gjoka

